



**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 09, datë 28.12.2020

**PËR  
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR  
BASHKIA SHKODËR, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 5, DATË 16.10.2017,  
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 5, datë 16.10.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 55 datë 23.12.2020 “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër të miratuar me Vendimin Nr. 5, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e Rregullores së Planit:
  - Kreun III “Rregulla të përdorimit të tokës”, Seksioni “Kategoria bazë A-Banim”;
  - Kreun IV “Rregulla për treguesit e zhvillimit”, shtohet neni “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së është i detyrueshëm”;
  - Kreun V “Infrastruktura Rrugore”, Seksioni “Parkimi”;
  - Kreun VI “Normat, standartet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore, historike dhe mjedisore”, Seksioni “Rregulla mbi ruajtjen e hapësirave natyrore për përmirësimin e standarteve mjedisore”;
  - Kreun XII “Rregullat mbi ndërtimet në tokën bujqësore”, shtohet neni “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”;
  - Kreun XIV “Rregullat për Zonat”;
  - Kreun XV “Rregullat për njësitë strukturore”;
  - Kreun XV “Rregullat për njësitë strukturore”, Seksioni “Pasaportat e njërive strukturore”.

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Ngarkohen Bashkia Shkodër dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të

Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.

3. Ngarkohen Bashkia Shkodër, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**


**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

